

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTERIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	07
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No	05-1941
Nr.l faqeve Br.stranica No.pages	-6-
Data: Datum: Date:	18.03.2025
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVLJA/MINISTRY OF HEALTH

DATË/A:	18.03.2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Z. Salvador Elmazi-Drejtor i Buxhetit-MFPT
CC:	Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave punës dhe Transfereve
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSh
NGA/OD/FROM:	Znj. Kadrije Berisha, ZKF-MSh
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027, Ministria e Shëndetësisë

I nderuari z. Elmazi, Drejtor i Buxhetit MFPT

Bazuar në neni 5 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe obligimet që dalin nga Organizatat Buxhetore bashkangjitur gjeni Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për Ministrinë e Shëndetësisë.

Me respekt,

SEKTORI I SHËNDETËSISË

1. Misioni

Ruajtja e shëndetit, promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimi i shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive.

2. Situata aktuale

Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2023 është angazhuar në hartimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve mbi bazën e një sistemi jo diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor të bazuara në analiza profesionale dhe të dhëna shkencore. Gjatë kësaj periudhe janë përcaktuar norma dhe standarde për sektorin e shëndetësisë, duke i respektuar standardet përkatëse ndërkombëtare si dhe janë ndërmarr të gjitha masat e përcaktuara me ligj për realizimin e veprimeve të duhura me qëllim të zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, banorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor.

Ministria, ka vazhduar koordinimin në menaxhimin e pandemisë COVID-19, edhe përkundër faktit që kemi pasur kryesisht një situatë të qetë epidemiologjike. Si rrjedhojë e situatës së qetë epidemiologjike Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin e datës 24.05.2023 ka shpallur mbylljen e emergjencës së shëndetit publik të shkaktuar nga COVID-19. Edhe pas mbylljes së emergjencës së shëndeti publik, institucionet përgjegjëse kanë vazhduar mbikëqyrjen e situatës duke zbatuar dhe monitoruar masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Sa i përket vaksinimit, Ministria ka siguruar për vitin 2023 dozat për vaksinën kundër COVID-19, por përgjigja e qytetarëve për vaksinim ishte pothuajse e papërfillshme dhe si rrjedhojë kemi në vazhdimësi skadim të afatit të përdorimit të vaksinave.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore, Ministri i Shëndetësisë ka miratuar planin strategjik për zbatimin e studimit të fizibilitetit “përmirësimi i infrastrukturës fizike të institucioneve të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar 2023-2026” që parasheh investime në pajisje dhe infrastrukturë në institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor në Republikën e Kosovës. Përmes këtij plani strategjik parashihet sigurimi i pajisjeve për spitale të përgjithshme dhe klinikat e QKUK në vlerë prej 44 milion euro. Në Dhjetor 2023 ka filluar studimi i fizibilitetit fazës e dytë ku do të realizohet vlerësimi për korridoret e ngrohta, qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe Hospica. Mjetet financiare për realizimin e këtij studimi 1 milion euro. janë ndarë nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor.

Sa i përket hartimit të planeve strategjike dhe planeve të veprimit, Ministria ka vazhduar me aktivitetet e parapara në zbatim të Planit kombëtar për zhvillim 2023-2025 dhe të Planit kombëtar për integrim Evropian. Gjatë vitit 2023 janë miratuar njëzetë (20) plane strategjike dhe plane të veprimit. Sa i përket draftit të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2023-2030, aktualisht është në fazën e adresimit të rekomandimeve nga Zyra për planifikim strategjik në Zyrën e kryeministrit. Ndërsa Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030 është finalizuar dhe është në fazën e konsultimeve ndërministrore.

Në zbatim të programit legjislativ, në Kuvend është miratuar projektligji për rregullimin e çmimeve të barnave që ndikon në uljen e çmimit të barnave dhe ulë koston e shpenzimeve në

buxhetet e familjeve. Gjithashtu është miratuar dhe projektligji për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, ndërsa në leximin e parë projektligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi janë miratuar udhëzimi administrativ për trajtimi mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, udhëzimi administrativ kushtet dhe procedurat për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore në institucionet private, udhëzimi administrativ për praktikën dhe provimin profesional për profesionistët shëndetësor dhe udhëzimi administrativ për vërejtjet e kombinuara në paketimin e duhanit, udhëzimi administrativ për shkollim specialistik, udhëzimi administrativ për udhërrëfytes dhe protokolle klinike. Akte nënligjore që janë miratuar në Qeveri janë Statuti i SHSKUK-së dhe udhëzimi administrativ për licencimin e profesionistëve shëndetësor të huaj dhe rregullorja për shtesën e nëpunësit të sistemit shëndetësor. Ministria po ashtu ka finalizuar projektligjin për shëndetësi dhe projektligjin për sigurim shëndetësor të cilat janë trajtuar edhe nga ekspertiza e marrë nga Komisioni Evropian.

Sa i përket zhvillimit të sistemit të informimit shëndetësor, është miratuar studimi i fizibilitetit për sistemin e informimit shëndetësor që ka krijuar mundësinë që bazuar në dëshmi të hartohet plani strategjik për SISH 2024-2030. Plani Strategjik për SISH është hartuar dhe aktualisht është në fazën e opinionëve ndërministrorë. Nja nga hapat e rëndësishëm është edhe zhvillimi i modulit të përzgjedhjes së mjekut familjar në modulën BHIS, i cili tashmë është i ndërlidhur me platformën e-Kosova, me qëllim që t'ju mundësohet qytetarëve të bëjnë aplikime online në përzgjedhjen e mjekut familjar në zonën e banimit të tyre për katër (4) komunat që janë pilot projekt (Prishtina, Prizreni, Istogu, Lipjani). Ministria ka zhvilluar trajnimet e nevojshme për përdorim të modulit të vaksinimit të rregullt dhe me indikacione për komuna të ndryshme. Është punuar në shtrirjen e rrjetit qeveritar dhe konfigurimin e pajisjeve të rrjetit në QMF-të dhe AMF-të në komunat të cilat janë pilot projekt për zoonim: Prizren, Lipjan, Istog dhe Prishtinë (QMF5 dhe QMF6).

~~Ministria e Shëndetësisë ka miratuar Listën e re të barnave esenciale në vlerë prej 63 milionë euro.~~ Në kuadër të programit të vaksinimit, Ministria ka përfshirë tre vaksina të reja në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve që kanë zgjeruar gamën e vaksinave për sëmundjet që mund të parandalohen sikur se vaksina kundër infeksioni me rotavirus, vaksina pneumokokut (PCV 13 valente) vaksina kundër (HPV) papillomavirusit dhe vaksinat për gripin sezonal. Për vitin 2024, Ministria ka arritur të siguroj rritjen buxhetit prej 5.8. milion euro për vaksina që këtë vit ishte 2 milion euro. Sa i përket furnizimit me barna dhe materiale shpenzuese për institucionet e kujdesit parësor shëndetësore, nga kontratat aktive të futura në sistem është 53%, ndërsa furnizimi me insulina, vaksina dhe terapi antituberkulare është 100%.

Ministra ka finalizuar projekt propozimin për grant i cili është miratuar në Bankën Botërore. Ky projekt synon financimin e aktiviteteve të sistemit të informimit shëndetësor, fuqizimit të kapaciteteve për sëmundje ngjitëse, menaxhimin e mbetjeve spitalore. Koordinimi i asistencës teknike është vazhduar përmes komunikimit të rregullt me agjencitë dhe partnerët strategjik që mbështesin sektorin e shëndetësisë. Përgjatë kësaj periudhe, Ministria e Shëndetësisë ka përfituar donacione me vlerën e përgjithshme 8,789,926.37 euro (barna pajisje, materiale shpenzuese, automjete).

Projekti emergjent COVID-19, për Kosovë i cili zbatohet nga njësia e projektit të Bankës Botërore mbështet reagimin emergjent ndaj pandemisë në Kosovë në kuadër të programit të përgatitjes dhe reagimit strategjik COVID-19. Gjatë periudhës raportuese njësia e projektit ka zbatuar aktivitetet që ndërlidhen me sigurimin e pajisjeve, zhvillimin e infrastrukturës dhe të vlerësimeve në fusha specifike.

3. Objektivat zhvillimore

MSh, bazuar në Strategjinë kombëtare për zhvillim, Ministria e Shëndetësisë ka për qëllim të përmirësojë kualitetin dhe qasjen në shërbime shëndetësore dhe të promovojë jetë të shëndetshme që të rritet jetëgjatësia e popullsisë e të ulët vdekshmëria në përgjithësi, por vdekshmëria e foshnjave dhe nënave në veçanti.

Ky qëllim zhvillimor do të arrihet përmes, këtyre objektivave strategjike:

- Përmirësimi i kualitetit dhe qasjes në shërbime shëndetësore;
- Mënyrë më e shëndetshme e jetesës;

Në kuadër të Planit kombëtar për zhvillim 2024-2026 janë paraparë **qëllimet zhvillimore** dhe **qëllimet strategjike** si në vijim:

Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbime shëndetësore

Ruajtja dhe përparimi i shëndetit

Masa strategjike të përcaktuara me Planin Kombëtar për zhvillim përfshijnë:

- Zhvillimi i kornizës ligjore për ri-organizimin e sektorit të shëndetësisë;
- Funksionalizimi i mekanizmave për parandalimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse;
- Funksionalizimi i mekanizmave për parandalimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve jo ngjitëse;
- Riorganizimi i shërbimeve shëndetësore;
- Sistemi i informimit shëndetësor (SISH) funksional dhe i integruar;
- Avancimi dhe rritja e zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- Riorganizimi i financimit të shëndetësisë për të siguruar qasjen universale;
- Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Përmirësimi i shërbimeve të vaksinimit për popullatën me theks tek grupet e cenueshme të shoqërisë dhe rritja e gamës së vaksinave;
- Përmirësimi i shëndetit të nënës, fëmijës dhe adoleshentëve;
- Zvogëlimi i mbetjeve spitalore;

Tabela 1. Përmbledhjese e buxhetit

Ministria e Shëndetësisë	Viti 2023 Shpenzimi	Viti 2024 Buxhetuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar	Viti 2027 Vlerësuar
Total	45,490,623	80,395,329	95,162,090	96,871,463	72,919,761
Numri i punëtorëve	1,425	1,425	1,482	1,482	1,482
Paga dhe mëditje	13,031,527.09	14,575,078.00	16,446,005	17,268,305	18,090,605
Mallra dhe shërbime	19,452,121.62	29,445,598.00	34,283,932	34,474,505	33,896,131
Shpenzime komunale	219,052.28	281,848.00	281,848	281,848	281,848
Subvencione dhe transfere	4,978,161.04	3,613,805.00	3,613,805	3,613,805	3,613,805
Shpenzime kapitale	7,809,760.66	32,479,000.00	33,601,500	31,078,000	14,837,372
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	38,955,719.65	71,525,329	88,227,090	86,716,463	70,719,761
Financimi nga të hyrat e AKP-së					
Të hyrat vetanake					
Financimet nga huamarrjet	1,113,828	1,020,000	1,200,000	1,200,000	200,000
Financimi nga deficitin buxhetor (2%) - 04					
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	4,782,498.20	7,850,000	5,735,000	8,955,000.00	2,000,000
Grantet nga Donatorët *	638,577.28	-			

Një rritje e theksuar e buxhetit vërehet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve që rritet me rritjen e buxhetit për Listen Esenciale të Barnave dhe në Paga dhe Shtesa për shkak që ka një numër të madhe të stafit në proces të rekurtimit.

Tabela 2: Trendet e financimit dhe shpenzimit 2023-2024 dhe vlerësimet e shpenzimeve 2025-2027

OB-Instituti Shtime Kombi me 8 (tetë) ulëse	Viti 2023 Shpenzimi	Viti 2024 Buxhetimi	Viti 2025 Vlerësimi	Viti 2026 Vlerësimi	Viti 2027 Vlerësimi
Total			50.000.00		
Numri I punëtorëve					
Paga dhe shtesa	0	0			
Mallra dhe Shërbime	0	0			
Shpenzime komunale	0	0			
Shpenzime kapitale	0	0	50.000.00		
Grantet Qeveritare	0				
Shënim: Instituti Spacial në Shtime dhe Shtëpia e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë nevojë për transportime për nevoja shëndetësore. Andaj, bazuar në këto nevoja kërkohet mundësia e blerjes së një kombi me (8) ulëse.					

Tabela 3: Trendet e financimit dhe shpenzimit 2023-2024 dhe vlerësimet e shpenzimeve 2025-2027

Renovimi i zyreve të pranimit dhe i nyjeve sanitare IKSHPK	Viti 2023 Shpenzimi	Viti 2024 Buxhetimi	Viti 2025 Vlerësimi	Viti 2026 Vlerësimi	Viti 2027 Vlerësimi
Total					
Numri I punëtorëve					
Paga dhe shtesa	0	0			
Mallra dhe Shërbime	0	0			
Shpenzime komunale	0	0			
Shpenzime kapitale	0	0	150.000.00	150.000.00	150.000.00
Grantet Qeveritare	0				
Shënim: Duke pasur parasysh rëndësinë për krijimin e kushteve të përshtatshme për punë për zyrtarët, kërkohet renovimi i zyreve të pranimit si dhe nyjeve sanitare 2025-2026 në mënyrë që të punët të vazhdojnë të zhvillohen në ambientet e përshtatshme .					

Nevoja për Staf shtesë Ministria e Shëndetësisë paraqet kërkesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për arsyeje që jemi fillim të projekteve të cilat kanë nevojë për resurse njërezore dhe ndër më të rëndësishmet është Funkcionalizimi i SISH. Nevojat për Ministrinë e Shëndetësisë për numër shtesë të stafit janë 31.